



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1420/2 prot.,

Datë 05.06.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “GERTI-1987” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01903-04-18-2024, me objekt: “Blerje ushqime për kopshte dhe çerdhe” dhe shkollën “Hamit Mullis”, me fond limit 7.350.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.05.2024.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “KADRA” SHPK me NIPT: K31321008J dhe me adresë: Rruga “Nënë Tereza”, Laknas, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kukës  
Adresa: Sheshi “Skenderbej“, Lagjia Nr.5, Kukës.
- Persona të interesuar:** Operatori ekonomik “GERTI-1987” SHPK me NIPT: L27606201D dhe me adresë: Fshati Çarshove, Objekt me nr. pasurie 47/435, Zona Kadastrale 1356, Permet, Gjirokastër.

Në datën 04.06.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dhe autoritetit kontraktor është protokolluar ankesa me numër elektronik A/2024/4153, datë 04.06.2024, dhe me nr. 1420/2024 prot, datë 04.06.2024 e operatorit ekonomik “KADRA” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-01903-04-18-2024, me objekt: “Blerje ushqime për kopshte dhe çerdhe” dhe shkollën “Hamit Mullis”, me fond limit 7.350.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.05.2024.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “GERTI-1987” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”.

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “KADRA” SHPK, në ankesën me numër elektronik A/2024/4153, datë 04.06.2024, dhe me nr. 1420/2024 prot, datë 04.06.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “GERTI-1987” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “GERTI-1987” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

### ***“1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT***

*Ofertuesi deklaron se:*

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;*
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

*Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.*

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.*

*Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.*

*Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*

***Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.***

*Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.*

*Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :*

➤ *Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.*

➤ *Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 05.06.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**